



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 48 Datë 21 . 03. 2007

Mbi

**Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100%
të aksioneve në Gallaher Group Plc tek Japan Tabacco Inc**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21 .03 .2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimi i datës 22 dhjetor 2006, për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 100% të aksioneve të shoqërisë Gallaher Group Plc tek Japan Tabaco Inc.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

1. **Japan Tabacco Inc**, me qendër në Tokio, Japoni, është shoqëria mëmë e një grupi ndërkombëtar, e rregjistruar sipas legjislacionit japonez dhe që ushtron veprimtarinë e tij kryesisht në industrinë e duhanit. Japan Tabacco Inc, ushtron veprimtarinë e vet në Japoni në tregun e prodhimit dhe të shpërndarjes së duhan-cigareve, ku ka edhe ekskluzivitetin për 8 marka cigaresh nga 10 që tregtohen në vend. Në tregun japonez, kjo kompani ushtron veprimtarinë e saj edhe në tregun farmaceutik, në fushën e kërkimit dhe zhvillimit të medikamenteve, si dhe në tregun e ushqimit, në prodhimin e pijeve, ushqimit të paketuar dhe erëzave.

Në tregun shqiptar **Japan Tobacco Inc** është e pranishme nëpërmjet tregtimit të markave të cigareve të tregtuara nga shpërndarësi ekskluziv Primal Trading, me qendër në Tiranë.

2. **JTI (UK) Management Ltd** (këtu më poshtë quhet “Japan Tobacco International (UK) Management Ltd”), me qendër në Londër, Britaninë e Madhe, është shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit anglez, e zotëruar dhe e kontrolluar për vendim marrje plotësisht nga Japan Tobacco Inc (mëma).

Japan Tobacco International (UK) Management Ltd është blerësi i 100% të aksioneve të Gallaher Group. JTI (UK) Management Ltd nuk kryen asnjë veprimtari, prodhimi apo tregtimi në fushën e duhan cigareve. Detyrimet e saj lidhen vetëm me realizimin e Ofertës për blerjen e kapitalit themeltar të nënshkruar (përfshirë këtu aksionet e depozituara amerikane (ADS) të Gallaher group Plc) që do të thotë blerjen 100% të aksioneve nga Gallaher Group.

3. **Gallaher Group**, e krijuar dhe regjistruar sipas legjislacionit anglez, ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin dhe shitjen e duhanit, **është shitësi i 100% të kapitalit që ka në zotërim.** Gallaher Group ushtron veprimtarinë e vet në tregun e prodhimit dhe të shpërndarjes së duhan-cigareve, duke zënë vendin e pestë në tregun ndërkombëtar. Grupi ka pozicion kryesues në: Austri (me markën Memphis), Irlandë (me markën Benson & Hedges dhe Silk Cut), Rusi (me markën LD), Kazakistan dhe Ukrainë (me markën Sovereign), Suedi dhe Britani. Gallaher Group është e pranishme në tregun e Vendeve Balltike, Poloni, Azi, Afrikë dhe në Lindjen e mesme.

Gallaher Group është e pranishme në tregun shqiptar nëpërmjet markave të cigareve të tregtuara nga shpërndarësi ekskluziv Kuinda Sh.p.k, me qendër në Pogradec.

4. Për vitin 2005, xhiro e Japan Tobacco Inc është :

- në tregun ndërkombëtar është **368.694** miliard lekë
- në tregun kombëtar është **669.737** milion lekë;

5. Për vitin 2005, xhiro e Gallaher:

- në tregun ndërkombëtar është **1.546 miliard lekë.**
- në tregun kombëtar është **57 milion lekë.**

6. Pjesa e tregut që zotëron në tregun kombëtar Gallaher dhe Japan Tobacco Inc është respektivisht, 0.3 dhe 17 % për vitin 2005. Ndërsa për vitin 2006 të dyja shoqëritë kanë njohur rritje të tregut dhe kishin respektivisht 1.8 dhe 22.8 për qind të tregut. Edhe pas bashkimit, Japan Tobacco-Gallaher mbeten të dytët në tregun kombëtar.

7. Transaksioni i realizuar nëpërmjet shitblerjes të paketës 100% të aksioneve nga Japan Tabaco Inc, përbën një përqëndrim në kuptimin e nenit 10, pika 1 shkronja a e Ligjit, si dhe përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1 të Ligjit.

8. Ky transaksion sjell ndryshime në strukturën në përgjithësi si të tregut ndërkombëtar të duhan cigareve ashtu edhe atij kombëtar, duke rritur pozitën gjeografike të Japan Tobacco Inc., rritjen e produkteve (markave) në

treg, por njëkohësisht rrit konkurrueshmërinë e tij ndaj konkurrentëve që udhëheqin sot tregun e këtij produkti.

9. Tregu përkatës

a) Tregu i produktit:

Japan Tabacco Inc dhe Gallaher janë të pranishme në tregun shqiptar me produktin duhan – cigare të markave **Camel, Mild Seven, Salem, Winston, Benson&Hedges, Silk Cut, Mayfair** dhe **Sovereign**.

b) Tregu Gjeografik: Territori i Shqipërisë.

Palët pjesëmarrëse në përqëndrim në tregun kombëtar, janë të pranishme vetëm nëpërmjet shitjes së cigareve të markave të ndryshme. Cigaret e importuara nga shpërndarësit ekskluzivë të përcaktuar, shpërndahen në tregun e brendshëm, respektivisht nga: Primal Trading Shpk për Japan Tabacco dhe Kuinda Sh.p.k.pë Gallaher.

10. Vlerësimi i impaktit në konkurrencë

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit 100% të aksioneve në Gallaher Group Plc nga Japan Tabacco International (UK) Management Ltd, që vepron në emër të Japan Tabacco Inc. dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të Japan Tabacco Inc në nivelin e shpërndarjes në tregun kombëtar, por rrit efikasitetin e tregut të produktit. Për pasojë nuk kemi kufizim të konkurrencës në këtë nivel tregu.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të aksioneve të Gallaher Group Plc tek Japan Tabacco International (UK) Management Ltd, me qendër në Londër, Britaninë e Madhe

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R